



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO  
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E  
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA  
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

***PROJEKTI PËR PËRMIRËSIMIN E PJESËSMARRJES NË ARSIM II (EPIP II) – MASHT,  
I FINANCUAR NGA BANKA BOTËRORE***

Adresa: Drejtoria e Qendrës së Studentëve, Rr. “Agim Ramadani”; Kati II,  
Tel: (381)-(38)-244-974;  
Fax.: (381)- ( 38) 244 975

Projektit për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim II (EPIP II), financohet nga Banka Botërore përmes dy fondeve për grante: CIDA Kanadeze (Agjencia Kanadeze për Zhvillim Ndërkombëtar) si dhe Fundi PCF (Fondi Pas-Konflikt). Projektit ka filluar në shtator 2007 dhe do të zgjas deri në fund të shkurtit 2009.

**Objektivi i Projektit EPIP -II**

Objektivi i përgjithshëm dhe afatgjatë i Projektit për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim II (EPIP II) është që të përkrahë qeverinë e re të Kosovës së pas-statusit në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies dhe avancimin e gjithëpërfshirjes dhe tolerancës në arsim. Më konkretisht, EPIP II synon të identifikojë mjete efektive për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies, të nxënies dhe të arsimit gjithëpërfshirës që do të shërbente si bazë projektet e ardhshme për mbështetjen e arsimit kosovar.

**Komponentët e Projektit EPIP II**

Projektit ndahet në këto komponente:

- I.** Grantet për Shkollat - Grantet për Zhvillimin e Shkollave
- II.** Grantet Komunale - Grante për Zhvillimin e Arsimit në Komuna
- III.** Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA)
- IV.** Monitorimi dhe Vlerësimi

**I. Grantet për Zhvillimin e Shkollave**

Objektivi i projektit është që të mbështesë përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve të mësimdhënies dhe nxënies duke përfshirë 90 shkollat me proporcion më të lartë të grupeve minoritare dhe familjeve të varfra përmes zbatimit të planeve për zhvillim të shkollave.

Projekti mbështet shkollat në përgatitjen dhe zbatimin e planeve zhvillimore të shkollave, të cilat përqendrohen në përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve të mësimdhënies e të nxënies dhe në krijimin e një ambienti gjithëpërfshirës të të nxënimit me qëllim të inkurajimit të gjithë nxënësve që të kenë qasje në shkollë. Projekti do të përfshijë rreth 90 shkolla në tri regjione: Mitrovicë, Prishtinë dhe Prizren.

Shkollat pjesëmarrëse në projekt do të përzgjidhen nga Ekipi Komunal për Grante Shkollore (EKGS) duke u bazuar në problemet e dokumentuara të qasjes dhe mbajtjen e nxënësve në shkolla në zonat që mbulohen nga shkolla, dhe në bazë të proporcionit të nxënësve nga grupet minoritare dhe nga niveli i varfërisë së komunës përkatëse.

Grantet do të jepen mbi bazën e Planeve Zhvillimore të Shkollave dhe Projekt Propozimeve për grante, të cilat do të vlerësohen nga Këshilli për Aprovimin e Granteve Shkollore (KAGSH). Grantet do të financojnë trajnime, aktivitete me komunitetin, furnizimin e shkollës me materiale mësimore edukative dhe furnizime tjera. Shkollat pjesëmarrëse po ashtu do të përgatisin planin e monitorimit dhe vlerësimit dhe një raport të shkurtër të aktiviteteve për sigurimin e cilësisë.

#### **Objektivat specifike të Granteve për Zhvillimin e Shkollave janë:**

- Të ofrojë financim për shkollat, si ndihmë për rritjen e numrit të nxënësve të regjistruar, vijimit dhe përfundimit të arsimit fillor dhe të mesëm.
- Të krijoj një ambient më të mirë të mësimdhënies dhe nxënies për të përmirësuar rezultatet e nxënësve.
- Të forcojë kreativitetin dhe kapacitetin e mësimdhënësve që të ofrojnë mësimdhënie dhe nxënie cilësore.
- Të përmirësojë cilësinë në arsim.
- Të nxis prindërit dhe komunitetin që të përfshihen në aktivitetet e atyre shkollave të cilat janë përzgjedhur për të marrë pjesë në projekt.
- Të forcojë rolin e Këshillave të shkollave për të siguruar qasje për komunitetin vendor.
- Të forcojë kapacitetin e shkollave për planifikim dhe menaxhim të burimeve drejt realizimit të vizionit të tyre për zhvillimin e ambienteve më të mira për mësim.
- Të promovojë pjesëmarrjen e administratorëve në nivelin vendor, këshillave të shkollës dhe komunitetit në planifikimin e arsimit dhe realizimit.

## **II. Grantet Komunale për Zhvillimin e Arsimit**

Komponenta e Granteve Komunale për Zhvillimin e Arsimit synon të forcojë kapacitetet institucionale të komunave në identifikimin e nevojave të shkollave përmes planifikimit të nisur nga shkolla dhe në organizimin e aktiviteteve arsimore në tërë komunën të cilat do të afirmonin përmirësimin e cilësisë, arsimimin gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrjen e komunitetit.

Kjo komponentë synon të zhvillojë kapacitetet e drejtorive komunale të arsimit, të financave dhe të prokurimit në administrimin dhe në menaxhimin e ofrimit të shërbimeve arsimore. Pesë komuna në tri rajone do të përzgjidhen si komuna pilot dhe, varësisht nga numri i shkollave, do të përfitojnë nga 15,000-30,000 €

### **Objektivat specifike të Granteve Komunale për Zhvillimin e Arsimit**

Në kuadër të kësaj komponente komunat mund të parashohin propozim projekte për grante në këto fusha:

- Programe të arsimit gjithëpërfshirës, përfshirë avancimin e mirëkuptimit ndëretnik.
- Fonde komunale për fëmijët me pasoja nga konflikti (për shembull, përkrahje për tekste shkollore).
- Programe aftësimi për menaxhimin e shkollës për drejtorët dhe administratën e shkollës
- Aftësim për vlerësimin e punës së mësimit (vlerësim i brendshëm në nivel shkollë dhe vlerësim i jashtë në nivel komune).
- Takime profesionale (konferenca) për këmbim të përvojave .
- Biblioteka mobile
- Mjete mësimore
- Menaxhimi financiar, prokurimi, administrata dhe aftësimet të tjera relevante për zyrtarët e Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe Drejtorisë së Prokurimit.

### **III. Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA)**

Në këtë komponentë është paraparë një shumë mjaft e vogël mjetesh dhe parashihet të organizohen trajnime me qëllim ngritjen e kapaciteteve në nivel shkollë, komuna dhe në nivel të MASHT> Trajnimi ka të bëjë me mbledhjen, futjen e të dhënave në sistem dhe mënyrat se si mund të shfrytëzohen dhe analizohen këto të dhëna.

### **IV. Monitorimi dhe Vlerësimi**

Kjo komponentë përbëhet nga tri aktivitete.

1. MASHT do të zhvillojë një hulumtim rreth braktisjes sidomos për shkallën e tranzicionit nga arsimi i detyrueshëm në arsimin e mesëm të lartë me qëllim të konstatimit të arsyeve për nivelin e tanishëm të ultë, sidomos në mesin e nxënësve femra dhe ndër minoritetet etnike jo-serbe. Sigurimi i mundësive të barabarta për arsimim të mesëm të lartë për të rinjtë pa marrë parasysh gjininë apo përkatësinë etnike shihet si e një rëndësie vendimtare në Kosovën e pasluftës.
2. MASHT do të organizojë një vlerësim të pavarur të efekteve të të dy komponentëve – Granteve për Zhvillimin e Shkollave dhe Granteve Komunale për Zhvillimin e Arsimit) dhe do ta krahasojë e vlerësojë efektivitetin e llojeve të ndryshme të skemave të granteve: (1) përkrahjen e komunave në menaxhimin e aktiviteteve arsimore në tërë komunën, (2) përkrahjen e drejtpërdrejtë të shkollës, dhe (3) një kombinim të këtyre të dy qasjeve.
3. MASHT do të organizojë auditimin e llogarisë së projektit me të përfunduar të tij.

### **Njësia Koordinuese e Projektit**

Projekti menaxhohet nga MASHT përmes Njesisë Koordinuese të Projektit e cila ka gjithsejtë 4 konsulentë (të punësuar):

1. Koordinator i Projektit
2. Specialist të Financave
3. Specialist të Prokurimit
4. Asistent